

**AKT THEMELIMI**  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
**“Goodyear” Sh.p.k.**

Shoqëria Delta Cooperation And Investment sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M01726016N,, me adresë Autostrada Tr-Dr, Km 5, Godina Delta Sha., përfaqësuar nga Administratori Marenglen Ceci, atësia Vait, amësia Zybe, shtetas Shqiptar, lindur në Gramsh dhe banues në TIRANË, me adresë E Kavajës; Nd. 165; H. 26; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 18/03/1981 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 037299703 dhe nr. personal I10318194C.

Në përputhje me vullnetin e saj të lirë dhe mbeshtetur në Ligjin me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me Ligjin me Nr. 131/2015, “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” themeloi sot me datën 19.02.2024, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“Goodyear”** Sh.p.k me kushtet e mëposhtme:

**Neni 1**

Themeluesi Shoqëria “Delta Cooperation And Investment” Sh.p.k, do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta quajë **“Goodyear”** Sh.p.k.

**Neni 2**

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Mëzez, Autostrada Tiranë- Durrës, Km1.5, Godina Delta, Zona Kadastrale 2679, nr.Pasurie 34/86, Mëzez Tiranë. Me vendim të Ortakëve mund të hapen degë, filiale ose përfaqësi, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Neni 3**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe në statutin e shoqërisë, ose me vendim të Ortakëve.

**Neni 4**

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë: Ortakët e Shoqërisë.  
Administratori i kësaj shoqërie është Znj.Ermira Varvarica, e bija e Muhamet , e datëlindjes 24/09/1979, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, Rruga “Dibrës”, e identifikuar me leternjoftim nr.032864 dhe Nr. Personal H95924102U.

**Neni 5**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të trete; b.Investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në



përgjithësi; c. Shitja e njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti; d. Administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet në projektet e zhvillimit në zonat e turizmit për qëllime rekreative dhe akomoduese; e. Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj. f. Vlerësim te pasurive te paluajtshme. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Mund të lidhë kontrata të dyanshme aktivi dhe pasivi me institutet e kreditit të autorizuara nga ligji dhe me shoqëritë dhe firmat private, të japë garanci reale edhe për të tretët dhe gjithçka që është e nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

#### Neni 6

Diskutimin mbi krijimin e një shoqërie tregtare në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, të emëruar Goodyear, me kapital prej 10,000, 000 lekë.

Pas diskutimeve, Asambleja e Ortakëve duke u mbështetur në Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9920, date 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH", Ligjin Nr. 8438, date 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", dhe statutin e shoqërise, ortaku i vetem, pasi shqyrtoi rendin e dites, me vullnet të lirë dhe të plotë:

#### VENDOSI

1. Miratimin e krijimit të një shoqërie tregtare në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me kapital fillestar prej 10,000, 000 lekë.
2. Emri i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar do të jetë Goodyear
3. Ngarkohet administratori i shoqërisë të nënshkruajë aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

Vendimi i mësipërm i shoqërisë mbyll me rendin 3 (tre), regjistrohet dhe hyn në fuqi menjëherë, kjo bazuar në nenet përkatëse të statutit të shoqërise dhe të ligjeve të cituar më sipër.

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 10,000,000 lekë.

#### Neni 7

Kapitali themeltar është depozituar prej tij në një llogari të hapur në emër të shoqërisë "Goodyear" Sh.p.k në formim e sipër.

#### Neni 8

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akti themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj dhe ne dispozitat e Ligjit me Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Ligjit me Nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"



## Neni 9

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

### THEMELUESI

Shoqëria “Delta Cooperation And Investment” Sh.p.k

Administratori

Marenglen Ceci

